



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KRYEVEKUTIT TE KOMUNES/NAJINIST PREDSENIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR/CABINET

Nrësia Nr./Pr./No. 02 (Kabineti i Kryetari të Komunës)
Nr./Br./No. 7734 Nr. i faq./Str.sht./No. pg. 79
Data/Datumi/Date 5 / 8 / 26
RAHOVEC, 05.08.2026

**Procesverbal nga takimi me qytetarët e
Rahovecit, me fokus përfaqësuesit e lagjeve të
qytetit I, II, III dhe IV.**

I. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Në kuadër të procesit të përgatitjes së Buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2027, ishte planifikuar të mbahej dëgjim buxhetor me qytetarët e Rahovecit, me fokus të veçantë përfaqësuesit e lagjeve të qytetit I, II, III dhe IV.

Qëllimi i këtij dëgjimi ishte krijimi i mundësisë që qytetarët dhe përfaqësuesit e lagjeve të paraqesin kërkesat, nevojat dhe prioritetet e tyre për përfshirje në planifikimin buxhetor të Komunës për vitin 2027.

Dëgjimi ishte planifikuar në kuadër të procesit të konsultimit publik dhe me qëllim të rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e hartimit të buxhetit komunal.

II. MOSMBAJTJA E DËGJIMIT BUXHETOR

Afrim Limani: Në kohën e paraparë për mbajtjen e dëgjimit buxhetor u bë përgatitja për zhvillimin e takimit dhe pritjen e qytetarëve dhe përfaqësuesve të lagjeve të qytetit I, II, III dhe IV.

Megjithatë, në vendin dhe kohën e përcaktuar për mbajtjen e dëgjimit nuk u paraqitën pjesëmarrësit e planifikuar. Për shkak të mungesës së pjesëmarrësve dhe pamundësisë për zhvillimin e diskutimit me qytetarët, dëgjimi buxhetor nuk mundi të mbahej.

U konstatua se, për shkak të mungesës së pjesëmarrësve, nuk ishte e mundur që të evidentoheshin drejtpërdrejt kërkesat, propozimet dhe prioritetet e qytetarëve të lagjeve të qytetit I, II, III dhe IV për Buxhetin e Komunës së Rahovecit për vitin 2027.

III. KONSTATIMI

Në bazë të situatës së krijuar, u konstatua se:

- dëgjimi buxhetor ishte planifikuar dhe organizuar për qytetarët dhe përfaqësuesit e lagjeve të qytetit I, II, III dhe IV;
- pjesëmarrësit e ftuar nuk u paraqitën në takimin e planifikuar;

IV. PËRFUNDIMI

Për shkak të mungesës së pjesëmarrësve, **dëgjimi buxhetor me qytetarët e Rahovecit, me fokus përfaqësuesit e lagjeve të qytetit I, II, III dhe IV, nuk u mbajt.**

Ky procesverbal hartohet për të dokumentuar mosmbajtjen e dëgjimit buxhetor dhe mungesën e pjesëmarrjes së qytetarëve në takimin e planifikuar.

Komuna e Rahovecit mbetet e hapur për pranimin e kërkesave dhe propozimeve të qytetarëve përmes mekanizmave të përcaktuar për konsultim dhe pjesëmarrje publike, me qëllim që nevojat e komunitetit të merren parasysh gjatë procesit të përgatitjes së Buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2027.